



Lehtësimi për Përafrim me Acquis të BE

Mbështetje e mëtutjeshme zhvillimit të tregtisë në Kosovë

Nr. Identifikues i Projektit

EuropeAid/138565/DH/SER/XK

Kontrata e Shërbimit Nr. 2018/395-320

Raporti

Tregtia e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut me BE:

Rishikimi i Koncesioneve të MSA-s

Mars, 2019



Kontakt personat tuaj në
GFA Consulting Group GmbH janë

Z-sha Martina Bernauer (Drejtoreshë e Projektit)
Z. Luis Abugattas (Udhëheqës Ekipi)

Kosovë

**Mbështetje e mëturjes zhvillimit të tregtisë
në Kosovë**
Numri i Kontratës 2018/395-320

Raporti

Akt. nr. 1.2.2: Formulimi i interesave të Kosovës dhe pozitës së mundshme në EFTA

Autori

Z. Agon Nixha

Mohim

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe GFA Consulting Group GmbH dhe në asnjë
mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian*

GFA Consulting Group GmbH

Eulenkrugstr. 82
D-22359 Hamburg
Gjermani

Tel: +49 (40) 6 03 06 170
Fax: +49 (40) 6 03 06 159
E-mail: martina.bernauer@gfa-group.de

Përmbajtja

Tabelat dhe Grafikat	2
Shkurtesat	3
1. Hyrje	4
2. Tregtia e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) me Botën	6
2.1. Pasqyra e Përgjithshme e Tregtisë së Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit)	6
2.2. Zbërthimi gjeografik i Tregtisë së produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit)	8
2.3. Zbërthimi i Tregtisë së Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit), sipas Krerëve	9
3. Tregtia e Produkteve Bujqësore dhe të peshkut (Peshkimit) me BE-n	11
3.1. Pasqyra e Përgjithshme e Tregtisë së Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) me BE-n	11
3.2. Tregtia e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) me BE-n, sipas Orientimit Gjeografik	13
3.3. Tregtia e Produkteve Bujqësore dhe të peshkut (Peshkimit) me BE-n, sipas Krerëve	14
3.4. Tregtia e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) me BE-n, sipas Kapitujve	15
3.5. Tregtia e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) me BE-n, sipas produkteve (8-shifrore)	15
3.6. Produktet e Reja Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Tregtuara pas MSA-s	19
4. Koncesionet dhe Tarifat Ekzistuese	21
5. Vërejtjet Përfundimtare	25
Shtojcat	27
Shtojca Ia	27
Shtojca Ib	28

Tabelat dhe Grafikat

<i>Tabela 1: Eksportet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës gjatë 2014-2018, sipas Krerëve (në 000 EUR)</i>	10
<i>Tabela 2: Importet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës gjatë 2014-2018, sipas Krerëve (në 000 EUR)</i>	10
<i>Tabela 3: Eksportet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës me BE-n gjatë 2014-2018, sipas Krerëve (në 000 EUR)</i>	14
<i>Tabela 4: Eksportet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës me BE-n gjatë 2014-2018, sipas Kapitujve (në 000 EUR)</i>	15
<i>Tabela 5: Eksportet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës me BE-n gjatë 2014-2018, 8-shifror të NK (në 000 EUR)</i>	16
<i>Tabela 6: Importet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës nga BE gjatë 2014-2018, sipas Krerëve (në 000 EUR)</i>	17
<i>Tabela 7: Importet e Prod. Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës nga BE gjatë 2014-2018, sipas Kapitujve (në 000 EUR)</i>	18
<i>Tabela 8: importet e Prod. Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës nga BE gjatë 2014-2018, 8-shifror të NK (në 000 EUR)</i>	19
<i>Tabela 9: Produktet e Reja të Eksportuara në BE pas MSA-s</i>	20
<i>Tabela 10: Produktet e Reja të Importuara nga BE pas MSA-s</i>	20
<i>Tabela 11: Eksportet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut të Kosovës në BE, sipas Tarifave (në 000 EUR)</i>	22
<i>Tabela 12: Ndryshimi ndërmjet Eksporteve të Kosovës me Pjesën Tjetër të Botës dhe me BE-n (në 000 EUR dhe Përpjestimet) ...</i>	23
<i>Tabela 13: Importet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës, sipas Tarifave (në 000 EUR dhe %) ...</i>	23
<i>Tabela 14: Ndryshimi ndërmjet Importeve të Kosovës me Pjesën Tjetër të Botës dhe me BE-n (në 000 EUR dhe Përpjestime).....</i>	24
<i>Grafika 1: Eksportet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës gjatë 2014-2018 (në 000 EUR)</i>	6
<i>Grafika 2: Importet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës gjatë 2014-2018 (në 000 EUR)</i>	7
<i>Grafika 3: Disbalansi i Tregtisë së Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) gjatë 2014-2018 (në 000 EUR)</i>	7
<i>Grafika 4: Eksportet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës gjatë 2014-2018, sipas Destinacioneve Kryesore (në 000 EUR)</i>	8
<i>Grafika 5: Importet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës, sipas Partnerëve Kryesor të Importeve (në 000 EUR)</i>	9
<i>Grafika 6: Eksportet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës me BE-n gjatë 2014-2018 (në 000 EUR)</i>	11
<i>Grafika 7: Importet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës nga BE gjatë 2014-2018 (në 000 EUR)</i>	12
<i>Grafika 8: Disbalansi i Tregtisë së Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) me BE-n gjatë 2014-2018 (në 000 EUR)</i>	12
<i>Grafika 9: Eksportet e Kosovës në BE gjatë 2014-2018, sipas Destinacioneve të Eksportit (në 000 EUR)</i>	13
<i>Grafika 10: Importet e Kosovës nga BE gjatë 2014-2018 (në 000 EUR), sipas Partnerëve të Importit</i>	14
<i>Grafika 11: Eksportet e verës të klasifikuar si verë tjetër (në 000,000 Litra)</i>	22

Shkurtesat

AZHB	Agjencia për Zhvillim Bujqësor
MAT	Masat Autonome Tregtare
NK	Nomenklatura e Kombinuar
BE	Bashkimi Evropian
HL	Hektolitra
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit
KSA	Komiteti i Stabilizim Asocimit

1. Hyrje

Pas një sërë negociatash që u zhvilluan gjatë vitit 2013 dhe 2014, Bashkimi Evropian (BE) dhe Kosova nënshkruan Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) me 22 tetor, 2015, në Strasburg. Kjo marrëveshje u miratua më pas nga Qeveria e Kosovës dhe hyri në fuqi me 1 prill, 2016. Një nga shtatë synimet e kësaj marrëveshjeje është promovimi i marrëdhënieve të harmonizuara ekonomike dhe zhvillimi gradual i zonës së tregtisë së lirë midis BE-s dhe Kosovës. Në përputhje me këtë objektiv, të dyja palët u zotuan t'i ofrojnë njëra tjetrës koncesione tregtare në produktet bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) (kapitujt 1-24 të Nomenklaturës së Kombinar).¹

Në Nenin 28, Nenin 30, dhe Nenin 31 të kësaj marrëveshjeje, BE-ja ra dakord që të çrrënjos tarifat dhe detyrimet doganore që kanë efekt të njëjtë në të gjitha produktet bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) në Kosovë, me përjashtim të disa produkteve të mishit, sheqerëve dhe verës. Përveç kësaj, Kapitulli 7 dhe Kapitulli 8 i NK-s, të cilët përfshijnë produktet e pemëve dhe perimeve, do të përjashtohen vetëm nga tarifa *ad valorem*. BE-ja do të vazhdojë të vendosë tarifa të veçanta ndaj disa produkte të këtyre kapitujve dhe e rezervon të drejtën të veprojë kështu për produkte të tjera në të ardhmen. Vlen të përmendet se këto koncesione janë përmirësim i atyre që janë miratuar me Masat Autonome Tregtare (MAT) në vitin 2000.

Në Nenin 29, 30 dhe 32 të marrëveshjes, Kosova ra dakord të shfuqizojë edhe të gjitha kufizimet sasiore dhe detyrimet që kanë efekt të njëjtë për 1,044 produkte bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) nga 2,564 produkte. Për pjesën tjetër, reduktimet graduale të tarifave do të zbatohen në një periudhë prej pesë deri 10 vjeçare. Një numër i vogël i produkteve (14), sidomos qumështi, patatet, vera dhe disa të tjera, i nënshtrohen një detyrimi fiks prej 10 për qind.²

Neni 33 i MSA-s përcakton se më së largu tri vjetë pas hyrjes në fuqi (data e fundit është 1 prill, 2019), Komiteti i Stabilizim Asocimit (KSA) do të shqyrtojë “produktet një nga një dhe mbi një bazë të ndërsjellë të rregullt dhe të përshtatshme, mundësitë për t'i ofruar koncesione të mtejshme njëri tjetrit me synim zbatimin e një liberalizimi më të madh të tregtisë së produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit).” Është përpiluar një dokument i pozicionit për të ndihmuar Qeverinë e Kosovës të përcaktojë qëndrimin në negociatat e mundshme. Mirëpo, Qeveria e Kosovës duhet të bëjë analizën e saj për të vendosur nëse është politikisht dhe ekonomikisht e arsyeshme ta shtyjë këtë proces përpara. Për shkak të kompleksitetit të këtij procesi, asnjë nga vendet fqinje nuk e ka aktivizuar këtë klauzolë, e cila ishte gjithashtu pjesë e MSA-ve të tyre.

Ky dokument, i cili bazohet kryesisht në të dhënat tregtare nga Dogana e Kosovës,³ kërkon të hedhë dritë në marrëdhëniet tregtare ndërmjet Kosovës dhe BE-s për produktet bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) dhe të shqyrtojë koncesionet bilaterale për këto produkte.⁴ Dokumenti është hartuar si pjesë e një aktiviteti në Projektin “Mbështetje e mëtutjeshme zhvillimit të tregtisë në Kosovë”, i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE), menaxhohet nga Zyra e BE-s në Kosovë dhe implementohet nga GFA Consulting

¹ Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (2015). https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150430_saa.pdf

² Ibid.

³ Disa tabela përmbledhëse me të dhëna të përshtatshme tregtare të prodhuara nga autori janë ruajtur në USB disk, i cili i dorëzohet projektit së bashku me këtë dokument.

⁴ SAA (2015).

Group, Zyra Daneze për Patented he Marka Tregtare, Instituti Evropian për Politikë Publike dhe Këshilltarët e WTI.

Shqyrtimi i të dhënave të tregtisë bilaterale zbulon se MSA-ja midis Kosovës dhe BE-s duket se ka pasur ndikim pozitiv në tregtinë e produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit); si eksportet, ashtu edhe importet janë rritur në mënyrë të konsiderueshme dhe janë tregtuar diku 470 produkte të reja.

Një analizë e detajuar e modeleve dhe koncesioneve tregtare të parashikuara me MSA tregon se aktivizimi e Nenit 33 mund të mos rezultojë me përmirësime të rëndësishme për Kosovën. Në përgjithësi, nuk duket se tarifatat përbëjnë problem. Ka të bëjë më tepër me kufizimet e ofertës, siç janë: infrastruktura e dobët e cilësisë (mungesa e standardeve sanitare dhe fito-sanitare); mungesa e testimit dhe certifikimit të duhur; objektet e dobëta të përpunimit; toka e pakonsoliduar; dhe kufizimet e përgjithshme në mjedisin e bizneseve, të cilat paraqesin më shumë problem për eksportet e produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) të Kosovës në BE. Vera e klasifikuar si verë tjetër, e cila i nënshtrohet kuotës; Direktiva e BE-s që ndalon hyrjen e produkteve të Kosovës me origjinë shtazore në BE; dhe e drejta e BE-s të vendosë tarifa të paparashikueshme në produktet nga Kapitulli 7 dhe Kapitulli 8, përbëjnë disa çështje që mund të diskutohen, nëse Qeveria e Kosovës vendos të aktivizoj Nenin 33. Nga ana tjetër, ka mundësi për të përshpejtuar periudhën e tranzicionit të tarifave për disa produkte bujqësore dhe të peshkut (peshkimit), siç janë: kafeja e pjekur, dhalla, kafeja e padekafenizuar, domatet, shalqinjët e freskët dhe disa produkte të tjera – përsëri nëse Qeveria e Kosovës vendos të aktivizoj Nenin 33. Kjo do të kontribuonte në shumëllojshmërinë e importeve dhe në parim, si rezultat i kësaj do të krijonte më shumë konkurrencë dhe çmime më të ulëta.

Pjesa tjetër e këtij punimi është e organizuar si në vijim. *Pjesa 2* jep një pasqyrë të tregtisë së produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) midis Kosovës dhe botës. *Pjesa 3* jep një analizë pak më të detajuar të tregtisë midis Kosovës dhe BE-s. *Pjesa 4* analizon koncesionet dhe tarifatat që janë ende në fuqi dhe jep një pasqyrë të disa mundësive për liberalizim të mëtejshëm. *Pjesa 5* jep disa vërejtje përfundimtare.


2. Tregtia e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) me Botën

Ky krye hedhë dritë mbi marrëdhëniet tregtare midis Kosovës dhe Botës për produktet bujqësore dhe të peshkut (peshkimit). Kjo pasqyrë është e rëndësishme sepse jep një kuptim të përgjithshëm mbi atë se çfarë mund të tregtohet edhe me BE-n.

2.1. Pasqyra e Përgjithshme e Tregtisë së Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit)

Vlera totale e eksporteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) në vitin 2018 ka arritur në EUR 63.3 milion. Kjo paraqet rritje prej 61 për qind krahasuar me vitin 2014. Rritja më domethënëse u shënua në dy vjetët e fundit. Për vlerat e detajuara të eksportit, shih Skicën 1.


Grafika 1: Eksportet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës gjatë 2014-2018 (në 000 EUR)



Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës.

Vlera totale e importeve të produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) është rritur çdo vit, nga EUR 616.1 milion në vitin 2014 në EUR 697.2 milion në vitin 2018, një rritje prej 13 për qind. Rritje pak më e madhe u shënua në dy vjetët e fundit, sidomos në vitin 2017 dhe 2018. Për më shumë informata të detajuara, shih Skicën 2.


Grafika 2: Importet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës gjatë 2014-2018 (në 000 EUR)



Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës.

Disbalansi tregtar në produktet bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) ka qenë jashtëzakonisht i lartë; ky hendek po zgjerohet çdo vit, nga EUR 576.7 milion në vitin 2014 në EUR 633.8 milion në vitin 2018, një rritje prej 10 për qind. Thënë ndryshe, vlera e importeve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) në vitin 2018 ishte pothuaj dhjetë herë më e lartë se vlera e eksporteve. Për vlera të detajuara të disbalansit tregtar, shih Skicën 3.

Grafika 3: Disbalansi tregtar në produktet bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) gjatë 2014-2018 (në 000 EUR)




Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës.

2.2. Zbërthimi gjeografik i Tregtisë së produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit)


CEFTA dhe BE-ja kanë qenë dy destinacionet kryesore për eksport të produkteve bujqësore dhe të peshkut të Kosovës. Vlera e eksporteve në këto dy destinacione në vitin 2018 ishte EUR 38.4 milion, respektivisht EUR 20.7 milion— që të dyja përbënin 92 për qind të të gjitha produkteve bujqësore dhe të peshkut në atë periudhë. Edhe CEFTA dhe BE-ja kanë kontribuar më së shumti në rritje të jashtëzakonshme të eksporteve të produkteve të tilla krahasuar me vitin 2016. Në skicën 4 është dhënë prezantimi vizual i orientimit gjeografik të eksporteve.

Grafika 4: Eksportet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës gjatë 2014-2018, sipas Destinacioneve Kryesore (në 000 EUR)



Pjesa më e madhe e importeve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) ka ardhur nga BE-ja dhe CEFTA. Vlera e importeve nga CEFTA dhe BE-ja në vitin 2018 ka arritur në EUR 289.7 milion, respektivisht EUR 233.7 milion. Që të dyja përbënin rreth 76 për qind të të gjitha importeve në atë vit. Brazili me EUR 46.6 milion në vitin 2018, pasuar nga Turqia me EUR 34.0 milion dhe EFTA me EUR 14.2 milion përbënin disa partnerë të tjerë kryesorë të importit. Përveç importeve nga CEFTA të cilat shënuan rritje prej rreth 6 për qind krahasuar me vitin 2016, të gjithë partnerët e tjerë kanë shënuar rritje në importe, ku BE-ja ka udhëhequr në këtë drejtim me rreth 13 për qind. Në skicën 5 është dhënë prezantimi vizual i orientimit gjeografik të eksporteve.

Grafika 5: Importet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës, sipas Partnerëve Kryesorë të Importit (në 000 EUR)



Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës.

2.3. Zbërthimi i Tregtisë së Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit), sipas Krerëve

Zbërthimi i të dhënave tregtare nga katër krerët kryesor të produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) tregon se në vitin 2018 Kosova kryesisht ka eksportuar produkte nga Pjesa IV: artikujt ushqimor, pijet dhe duhani, EUR 38.4 milion; dhe Pjesa II: produktet vegjetale, EUR 23.8 milion. Produktet e këtyre dy krerëve përbënin 98 për qind të të gjitha eksporteve të produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit). Krahasuar me vitin 2014, të dy krerët shënuan rritje; Pjesa IV, në veçanti, u rrit ndjeshëm, për 88 për qind.

Pjesëmarrja e Kreut I: kafshët e gjalla dhe produktet shtazore; dhe Kreut III: vajra dhe dhjamra prej kafshëve në eksportet totale të produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) ishin të papërfillshme – të dyja arrijnë EUR 1.6 milion apo më pak se 2 për qind në vitin 2018. Për më shumë informata mbi eksportet sipas krerëve, shih Tabelën 1.

Tabela 1: Eksportet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës gjatë 2014-2018, sipas Krerëve (në 000 EUR)

Krerët	2014	2015	2016	2017	2018
Kreu I: KAFSHËT E GJALLA DHE PRODUKTET SHTAZORE	309	666	775	846	724
Kreu II: PRODUKTET VEGJETALE	18,541	15,538	16,772	23,430	23,826
Kreu III: DHJAMRAT DHE VAJRAT SHTAZORE APO VEGJETALE	19	41	09	179	343
Kreu IV: ARTIKUJT USHQIMOR, PIJET DHE DUHANI	20,489	25,437	27,649	36,881	38,473
Totali i Përgjithshëm	39,359	41,683	45,205	61,336	63,367

Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës.

Të dhënat tregtare të zbërthyera sipas krerëve bujqësor dhe të peshkut (peshkimit) tregojnë se në vitin 2018 Kosova ka importuar EUR 385.0 milion (55 për qind të importeve totale) nga Kreu IV: artikujt ushqimor, pijet dhe duhani; EUR 151.7 milion (22 për qind) nga Kreu II: produktet vegjetale; EUR 132.0 milion (19 për qind) nga Kreu I: kafshët e gjalla dhe produktet shtazore; dhe EUR 27.3 milion (4 për qind) nga Kreu III: dhjamra dhe vajra shtazore apo vegjetale. Të gjithë këta krerë shënojnë rritje krahasuar me vitin 2014, edhe pse ka pasur luhajtje ndërmjet viteve. Për më shumë informata, shih Tabelën 2.

Tabela 2: Importet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) gjatë 2014-2018, sipas Krerëve (në 000)

Krerët	2014	2015	2016	2017	2018
Kreu I: KAFSHËT E GJALLA DHE PRODUKTET SHTAZORE	115,324	111,972	109,894	121,483	132,036
Kreu II: PRODUKTET VEGJETALE	133,045	143,434	147,920	148,781	151,750
Kreu III: DHJAMRAT DHE VAJRAT SHTAZORE APO VEGJETALE	24,912	25,615	27,863	28,362	27,930
Kreu IV: ARTIKUJT USHQIMOR, PIJET DHE DUHANI	342,837	352,681	373,054	395,891	385,535
Totali i Përgjithshëm	616,118	633,702	658,730	694,517	697,252

Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës.

Nuk ka nevojë për zbërthim të mëtejshme të krerëve me kusht që qëllimi i këtij kreu ishte të jepej një pasqyrë e përgjithshme për tregtinë e produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) me Kosovën dhe Botën.


3. Tregtia e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) me BE-n

Ky krye analizon tregtinë e produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) midis Kosovës dhe BE-s, duke filluar nga viti 2014 (dy vjetë para hyrjes në fuqi të MSA-s). Ai ka për qëllim të paraqes gjendjen e tanishme, të përmbledhë ndryshimet pas hyrjes në fuqi të MSA-s dhe të jepë disa indikacione për fushat e liberalizimit të mëtejshëm.

3.1. Pasqyra e Përgjithshme e Tregtisë së Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) me BE-n

Në pesë vitet e fundit, eksportet e produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) në BE kanë shënuar rritje të vazhdueshme, prej EUR 10.1 milion në vitin 2014 në EUR 20.7 milion në vitin 2018, një rritje prej rreth 103 për qind. Rritja më e madhe në eksporte (rreth 68 për qind) ndodhi një vit pas hyrjes në fuqi të MSA-s, që tregon se marrëveshja ka pasur efekt pozitiv në eksporte të produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit). Për më shumë informata, shih Skicën 6.


Grafika 6: Eksportet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës në BE gjatë 2014-2018 (në 000 EUR)



Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës.

Edhe importet e produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) kanë shënuar trend pozitiv, duke u rritur nga EUR 249.0 milion në vitin 2014 dhe 2015 në EUR 296.1 milion në vitin 2018. Kjo përbën një rritje prej rreth 19 për qind. Në fakt, rritja ka filluar në po të njëjtin vit kur MSA-ja hyri në fuqi. Për më shumë informata, shih Skicën 7. Mirëpo, është vërejtur një trend shumë i ngjashëm i importeve edhe me pjesën tjetër të botës.


Grafika 7: Importet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) nga BE-ja gjatë 2014-2018 (në 000 EUR)



Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës.

Siç tregojnë tashmë të dhënat e eksportit dhe importit, ekziston një disbalans i madh tregtar ndërmjet Kosovës dhe BE-s në produktet bujqësore dhe të peshkut (peshkimit). Që nga viti 2015, ky disbalans ka qenë në rritje çdo vit, duke arritur vlerën më të lartë në vitin 2018, EUR 275.4 milion. Në aspektin monetar, importet janë rritur për katër herë më shumë se eksportet pas hyrjes së marrëveshjes në fuqi. të. Për më shumë informata, shih Skicën 8.

Grafika 8: Disbalansi tregtar në Produktet Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës me BE-n gjatë 2014-2018 (në 000 EUR)




Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës.

3.2. Tregtia e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) me BE-n, sipas Orientimit Gjeografik

Zbërthimi i të dhënave tregtare sipas destinacioneve të eksportit tregon se Gjermania, Kroacia, Italia, Austria dhe Bullgaria ishin partnerët eksportues më të mëdhenj të produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) në pesë vitet e fundit. Në vitin 2018, Gjermania e kryeson listën e partnerëve eksportues me EUR 8.2 milion, e shoqëruar nga Bullgaria me EUR 1.7 milion, Kroacia me EUR 1.4 milion, Austria me EUR 1.3 milion, dhe Italia me EUR 1.0 milion – që së bashku përbëjnë 68 për qind të të gjitha eksporteve. Vetëm Gjermania përbënte rreth 40 për qind të të gjitha eksporteve. Ndërsa eksportet në Gjermani, Bullgari dhe Austri shënuan rritje në krahasim me vitin 2014, eksportet në Kroaci dhe Itali shënuan ulje të lehtë. Për më shumë informata, shih Skicën 9.


Grafika 9: Eksportet e Kosovës në BE gjatë 2014-2018, sipas Destinacioneve të Eksportit (në 000 EUR)



Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës.

Të dhënat mbi importet e produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) të Kosovës nga BE, nga ana tjetër tregojnë se Gjermania, Polonia, Italia, Kroacia dhe Sllovenia ishin dy partnerët kryesor të importit në pesë vitet e fundit. Në vitin 2018, Gjermania dhe Polonia ishin dy partnerët kryesor të importit për produkte të tilla me EUR 49.0 milion, respektivisht EUR 47.1 milion; të pasuara nga Italia me EUR 39.7 milion, Kroacia me EUR 30.0 milion, dhe Sllovenia me EUR 25.9 milion, që përbëjnë rreth 65 për qind të të gjitha importeve. Krahasuar me vitin 2014, importet e produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) nga të gjitha ato vende shënuan rritje, edhe pse kishte ngritje dhe ulje në vitet ndërmjet, siç është rasti i Gjermanisë. Për më shumë informata, shih Skicën 10.

Grafika 10: Importet e Kosovës nga BE-ja gjatë 2014-2018 (në 000 EUR), sipas Partnerëve Importues



Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës.

3.3. Tregtia e Produkteve Bujqësore dhe të peshkut (Peshkimit) me BE-n, sipas Krerëve

Tabela 3 përshkruan produktet bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) në BE, të zbërthyera sipas krerëve. Ajo tregon se në vitin 2018 gati 100 për qind e eksporteve të Kosovës në BE e përbënin produktet e renditura në Kreun II: produktet vegjetale, me EUR 12.3 milion; dhe Kreun IV: artikujt ushqimor, pijet dhe alkoolet, me EUR 8.3 milion. Krahasuar me vitin 2014, vlera e eksporteve nga këto dy seksione është rritur për 131 për qind, respektivisht 73 për qind. Një shumë shumë e papërfillshme, EUR 4.0 mijë, është krijuar nga produktet e Kreut III: vajrat apo dhjamrat vegjetale; dhe asgjë nuk është importuar nga kreu I: kafshët e gjalla dhe produktet shtazore. Edhe pse MSA-ja zbaton tarifën zero për shumicën dërrmuese të produkteve nga Kreu I, ekziston një Direktivë (BE) Nr 206/2010⁵ e cila ndalon produktet me origjinë shtazore të hyjnë në BE. Për ta sqaruar këtë, Kosova ka eksportuar një sasi të vogël të produkteve me origjinë shtazore në vendet tjera të botës, gjë e cila sugjeron se vendi po përballet me kufizimin e ofertës. Për më shumë informata, shih Tabelën 3.

Tabela 3: Eksportet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës në BE gjatë 2014-2018, sipas Krerëve (në 000 EUR)

Krerët	2014	2015	2016	2017	2018
Kreu I: KAFSHËT E GJALLA DHE PRODUKTET SHTAZORË	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
Kreu II: PRODUKTET VEGJETALE	5,348	4,569	4,699	10,195	12,334
Kreu III: DHJAMRAT DHE VAJRAT SHTAZORË APO	0,000	0,000	0,007	0,003	0,004
Kreu IV: ARTIKUJT USHQIMOR, PIJET DHE ALKOO	4,826	5,961	7,204	9,878	8,367
Totali i Përgjithshëm	10,175	10,530	11,910	20,077	20,705

Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës.

⁵ EU) No 206/2010 <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32010R0206>

3.4. Tregtia e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) me BE-n, sipas Kapitujve

Një analizë tjetër në nivel të kapitujve të NK-s tregon se në vitin 2018 frutat dhe arrat e ngrënshme (Kapitulli 8), me EUR 5.5 milion; pijet, alkoolet dhe uthullat (Kapitulli 22), me EUR 4.9 milion; tables (Kapitulli 7), me EUR 3.0 milion; përgatitje prej zarzavateve, frutave, arrave apo pjesëve tjera të bimëve (Kapitulli 20) dhe farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore (Kapitulli 12), me EUR 2.1 milion secila, përbënin rreth 87 për qind të të gjitha eksporteve të produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit). Të gjithë kapitujt e lartpërmendur kanë pasur rritje në krahasim me vitin 2014. Rritja më e rëndësishme u shënua tek frutat dhe arrat e ngrënshme (Kapitulli 8), rreth 361 për qind. Për më shumë informata, shih Tabelën 4.

Tabela 4: Eksportet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës në BE gjatë 2014-2018, sipas Kapitujve (në 000 EUR)

Kapitujt	2014	2015	2016	2017	2018
01: Kafshët e gjalla	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
02: Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
03: Peshku dhe kafshët guackore të nënujshme, molusqet dhe kafshët	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
04: Produktet bulmetore; vezët e zogjve; mjalti natyral	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
05: Produktet me origjinë shtazore, të pëarfshira apo të paspecifikuara	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
06: Pemët dhe bimët e tjera	0,012	0,005	0,045	0,057	0,078
07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	1,888	0,851	1,970	2,224	3,084
08: Frutat dhe arrat e ngrënshme	1,209	1,580	1,074	5,648	5,580
09: Kafe, çaj, mate dhe erëza	0,924	0,901	0,301	0,791	1,301
10: Drithera	0,095	0,001	0,003	0,020	0,102
11: Produktet e industrisë bluajtëse	0,016	0,016	0,028	0,020	0,030
12: Fara të tjera vajore dhe fruta me përmbajtje vajore	1,204	1,215	1,269	1,435	2,158
13: Lac, gomat, rrëshirat, lëngje dhe ekstrakte të tjera vegjetale	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
14: Materialet vegjetale që përdoren për thurje	0,000	0,000	0,008	0,000	0,001
15: Dhjamra dhe vajra shtazore apo vegjetale	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
16: Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshku apo krustaceve	0,000	0,000	0,001	0,000	0,000
17: Sheqeri dhe ëmbëlsira prej tij	0,039	0,070	0,079	0,094	0,148
18: Kakao dhe përgatitjet prej kakaos	0,242	0,269	0,249	0,230	0,300
19: Përgatitjet prej drithrave, miellit, niseshtes apo qumështit	0,618	0,965	0,776	0,872	0,619
20: Përgatitjet prej zarzavateve, frutave, arrave apo pjesëve të t	0,520	0,823	2,007	3,847	2,175
21: Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	0,032	0,068	0,097	0,035	0,127
22: Pijet, alkoolet dhe uthullat	3,374	3,766	3,996	4,799	4,997
23: Mbetjet dhe kthimet nga industritë ushqimore	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
24: Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
Totali i Përgjithshëm	10,175	10,530	11,910	20,077	20,705

Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës.

3.5. Tregtia e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) me BE-n, sipas produkteve (8-shifrore)

Tabela 5 përshkruan produktet më të eksportuara bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) në pesë vitet e fundit, të zbërthyer me NK 8-shifrore. Ujërat, përf. ujërat minerale dhe të gazuara, me sheqer të shtuar (CN:22021000), me EUR 2.6 milion; bimët efedra dhe pjesët e tyre (CN:12115000), me EUR 1.8 milion;

kërpudhat e thata dhe tartufet (CN:07123900), me EUR 1.5 milion; mjedrat e buta (CN:08102010), dhe manaferra, mana dhe rrushi i butë logan (CN: 08102090), me EUR 1.1 milion secila; kryesuan listën e produkteve më të eksportuara bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) në vitin 2018, që së bashku përbëjnë 40 për qind të të gjitha eksporteve. Është interesante se qysh në vitin 2014, dy nga këto produkte, sidomos kërpudhat e thata (CN:07123900) dhe tartufet dhe mjedrat e buta (CN:08102010), nuk janë eksportuar fare. Pjesa tjetër shënoi një rritje jo të rëndësishme krahasuar me atë periudhë. Trendi i eksporteve të mjedrave të buta (CN:08102010) i atribuohet mbështetjes së fuqishme (në formë të granteve) të cilat i siguron Ministria e Bujqësis, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në veçanti Agjencia për Zhvillim Bujqësor (AZHB). Specët e përgatitura apo të ruajtura me uthull (CN: 20019070) janë kategori tjetër që shënojnë vlerë të lartë të eksporteve në krahasim me të tjerat kur merret zërbërthimi i pesë viteve të fundit, edhe pse është shënuar rënie në vitin 2018.

Në mesin e këtyre produkteve, përveç verërave të prodhuara në BE, në kontejnerë që mbajnë ≤ 2 l (CN:22042178), të cilat së bashku me verërat e tjera i nënshtrohen kuotës prej 4 milion litrash, të gjitha produktet tjera të renditura në Tabelën 5 përjashtohen nga tarifat apo detyrimet tjera ekuivalente. Por, luhatjet në eksportet e disa produkteve pas MSA-s ndodhën për shkak të arsyeve që nuk kanë të bëjnë me tarifat. Në parim, nuk është aspak e jashtëzakonshme të priten disa oscilime të vogla në sasi aq të vogla të eksporteve.

Tabela 5: Eksportet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës në BE gjatë 2014-2108, sipas 8-shifrorëve të NK-s (në 000 EUR)

Malli (8 Shifror)	Tariffs	2014	2015	2016	2017	2018
22021000:Ujërat, përf. ujërat minerale dhe të gazuara, me sheqer shtesë	No	0,186	0,281	0,446	2,195	2,643
12115000:Bimët efedra dhe pjesët prej saj	No	0,000	0,000	0,000	1,293	1,897
07123900:Kërpudhat e thara dhe tartufet	No	0,367	0,096	0,930	1,255	1,560
08102010:Manaferra të buta	No	0,000	0,362	0,147	1,286	1,132
08102090:Mana të freskëta, rrush frengu i zi dhe mana	No	0,012	0,106	0,236	0,958	1,111
20019070:Specët e përgatitura apo të ruajtura me uthull apo acid acetik	No	0,225	0,279	1,230	1,920	0,965
08112031:Manaferra, të pagatuara apo të gatuara në avull apo të ziera në ujë	No	0,037	0,018	0,012	0,520	0,897
08112090:rrush frengu i zi, i pagatuar apo i gatuar në avull apo i zier në ujë	No	0,000	0,211	0,131	1,595	0,733
09012100:Kafeja e pjekur (përv. e dekafezuar)	No	0,225	0,557	0,173	0,493	0,672
08134095:Futat e thara, të ngrënëshme	No	0,035	0,178	0,196	0,188	0,590
07096010:Specët e freskëta apo të ftohura	No	0,155	0,208	0,271	0,275	0,451
08104090:Fruat të freskëta të llojit Vaccinium	No	0,608	0,350	0,093	0,231	0,382
07095990:Kërpudha të ngrënëshme të freskëta apo të ftohura	No	1,154	0,194	0,447	0,434	0,378
22042178: Verërat e prodhuara në BE, në kontejnerë që mbajnë ≤ 2 l	Yes	0,604	0,694	0,671	0,450	0,375
22011011:Ujërat minerale, natyrale, që nuk përmbajnë sheqer shtesë	No	0,320	0,364	0,500	0,741	0,357

Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës;MSA.

Tabela 6 paraqet importet e produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) në pesë vitet e fundit, të zërbërthyer sipas krerëve të NK-s. Në vitin 2018, produktet nga Kreu IV: artikuj ushqimor, pijet dhe alkoolët, përbënin shumicën (62 për qind) të importeve, me EUR 185.0 milion, që pasohen nga Kreu I: kafshët e gjalla dhe produktet shtazore, me EUR 62.3 milion (21 për qind); dhe Kreu II: produktet vegjetale, me EUR 41.4 milion (14 për qind); Kreu III: dhjamrat apo vajrat shtazore apo vegjetale përbënin një sasi më të vogël krahasuar me krerët tjerë, EUR 7.3 milion (2 për qind). Të gjithë krerët shënojnë rritje në krahasim

me vitin 2014. Rritja në Kreun IV ishte e vazhdueshme, gjë që nuk ndodh në krerët tjerë, ku shihen rënie të vogla në vitin 2015.

Tabela 6: Importet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës nga BE-ja gjatë 2014-2018, sipas Krerëve (në 000 EUR)

Krerët	2014	2015	2016	2017	2018
Kreu I: KAFSHËT E GJALLA DHE PRODUKTET SHTAT	49,980	49,268	51,731	55,922	62,342
Kreu II: PRODUKTET VEGJETALE	30,620	30,209	34,906	36,289	41,462
Kreu III: DHJAMRAT DHE VAJRAT SHTAZORE APO	6,130	4,985	5,845	5,610	7,323
Kreu IV: ARTIKUJT USHQIMOR, PIJET DHE ALKOO	162,284	164,547	169,919	178,025	185,034
Totali i Përgjithshëm	249,015	249,010	262,402	275,846	296,161

Zbërthimi i të dhënave të importit sipas kapitujve tregon se në vitin 2018 përgatitjet e ndryshme të ngrënshme (Kapitulli 21) me EUR 42.0 milion; duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit (Kapitulli 24), me EUR 41.7 milion; produktet bulmetore, vezët e zogjve, mjalti natyral (Kapitulli 4), me 34.8 milion EUR; pijet, alkoolet dhe uthullat (Kapitulli 22), me EUR 24.0 milion; përgatitjet prej drithrave, miellit, niseshtes apo qumështit (Kapitulli 19) me EUR 21.4 milion, përbënin 61 për qind të të gjitha importeve të produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit). Nga këta kapituj, përveç duhanit dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit (Kapitulli 24) që shënoi rënie gjatë viteve, të gjithë të tjerët shënuan rritje krahasuar me vitin 2014, edhe pse disa nga to me rënie të vogla qoftë në vitin 2015 apo në 2016. Trendi i rënies së importeve të duhanit është shkaktuar me ngritje të vazhdueshme të normës së akcizës, që me sa duket ka ndikuar në kërkesën e Kosovës.⁶ Për më shumë informata, shih Tabelën 7.

⁶ https://www.institutigap.org/documents/53812_EXCISE%20ON%20TOBACCO.pdf

Tabela 7: Importet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës nga BE-ja gjatë 2014-2018, sipas Kapitujve (në 000 EUR)

Chapters	2014	2015	2016	2017	2018
01:Kafshët e gjalla	6,888	5,784	4,664	3,329	9,136
02:Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit	15,209	17,272	16,791	19,967	17,765
03: Peshku dhe kafshët guackore të nënujshme, molusqet dhe kaf	0,212	0,177	0,082	0,209	0,554
04: Produktet bulmetore; vezët e zogjve; mjalti natyral	27,608	25,999	30,053	32,187	34,808
05: Produktet me origjinë shtazore, të pëarfshira apo të	0,063	0,037	0,141	0,229	0,080
06: Pemët dhe bimët e tjera	1,751	3,178	3,723	3,035	3,194
07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	5,036	4,862	5,242	5,222	5,270
08: Frutat dhe arrat e ngrënshme	7,853	6,671	8,544	9,136	9,295
09: Kafe, çaj, mate dhe erëza	5,333	5,609	6,346	6,869	7,666
10: Drithera	4,791	4,576	4,818	4,855	7,983
11: Produktet e industrisë bluajtëse	3,699	2,950	3,447	3,965	4,372
12: Fara të tjera vajore dhe fruta me përmbajtje vajore	1,942	2,210	2,514	2,898	3,213
13: Lac; gomat, rrëshirat, lëngje dhe ekstrakte të tjera vegjetale	0,215	0,154	0,271	0,309	0,469
14: Materialet vegjetale që përdoren përthurje	0,000	0,000	0,001	0,000	0,000
15: Dhjamra dhe vajra shtazore apo vegjetale	6,130	4,985	5,845	5,610	7,323
16: Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshku apo krustaceve	11,476	12,062	11,811	12,587	12,942
17: Sheqeri dhe ëmbëlsira prej tij	2,039	2,303	5,112	4,630	9,887
18: Kakao dhe përgatitjet prej kakaos	9,935	11,274	12,797	14,441	15,310
19: Përgatitjet prej drithrave, miellit, niseshtes apo qumështi	17,351	19,533	22,601	25,736	21,462
20: Përgatitjet prej zarzavateve, frutave, arrave apo pjesëve të tje	8,850	9,884	10,375	11,573	12,442
21: Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	31,353	33,144	35,062	37,380	42,040
22: Pijet, alkoolet dhe uthullat	21,560	19,768	18,975	20,619	24,036
23: Mbetjet dhe kthimet nga industritë ushqimore	3,966	4,808	4,085	3,662	5,123
24: Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	55,753	51,772	49,101	47,397	41,792
Totali i Përgjithshëm	249,015	249,010	262,402	275,846	296,161

Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës.

Tabela 8 përshkruan 15 produktet bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) më të importuara në nivel tetëshifror të NK-s gjatë pesë viteve të fundit. Në vitin 2018, të gjitha këto produkte kanë kontribuar me 44 për qind në importet e përgjithshme bujqësore dhe të peshkut (peshkimit). Cigaret, që përmbajnë duhan (CN: 24022090) me EUR 41.4 milion; përgatitjet ushqimore, që nuk përmbajnë yndyrë qumështi (CN: 21069092), me EUR 16.6 milion; përgatitjet ushqimore, që përmbajnë yndyrë qumështi (CN: 21069098), me EUR 11.1 milion; ujërat, përf. ujërat minerale dhe të gazuara, me sheqer të shtuar (CN: 22021000), me EUR 8.8 milion; dhe qumështi dhe kremi (CN: 04012091), me EUR 8.1 milion, kryesuan listën e importeve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit). Nga të gjitha këto 15 produkte të importit, 12 prej tyre shënuan rritje krahasuar me vitin 2014. Produktet që shënuan rënie ishin cigaret, që përmbajnë ujë duhani (24022090); ujërat përf. ujërat minerale dhe të gazuara, me sheqer të shtuar (CN: 22021000); dhe supat dhe lëngjet e mishit dhe përgatitjet prej tyre (CN: 21041000). Derisa arsyet për rënien e cigareve, që përmbajnë ujë duhani (24022090) u përmendën më parë, arsyeja më e mundshme për rënie të ujit përf. ujin mineral dhe të gazuar, me sheqer të shtuar (CN: 22021000) lidhet me konsolidimin e prodhuesve vendor. Kini parasysh se ky produkt është produkti më i eksportuar bujqësor dhe i peshkut (peshkimit) i Kosovës në BE (shih Tabelën 5). Nga ana tjetër, nuk dihen arsyet për rënie të supave dhe lëngjet e mishit dhe përgatitjet prej tyre (CN: 21041000). Nga të gjitha ato 15 produkte, vetëm njëri ka tarifën fikse, ndërsa katër të tjerët kanë tarifa që gradualisht do të ulen në periudhë kohore prej pesë deri në shtatë vjet.

Koncesionet në formë të shkurtimit të periudhës së uljes së tarifave mund të konsiderohen për katër të fundit, nëse Qeveria e Kosovës vendos të aktivizojë Nenin 33.

Tabela 8: Importet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës nga BE-ja gjatë 2014-2108, sipas 8-shifrorit të NK-s (në 000 EUR)

No.	Malli (8 Shifror)	Tarifat	2014	2015	2016	2017	2018
1	24022090:Cigaret, që përmbajnë duhan	Jo	55,742	51,630	49,022	47,344	41,704
2	21069092:Përgatitjet ushqimore, që nuk përmbajnë yndyrëra të qumështit	Jo	13,006	13,587	13,521	14,391	16,601
3	21069098:Përgatitjet ushqimore, që përmbajnë yndyrëra të qumështit	Jo	5,071	7,333	9,983	10,293	11,164
4	22021000:Ujërat, përf. Ujërat mineral dhe të gazuar, me sheqer shtesë	Jo	10,411	7,378	7,009	7,278	8,820
5	04012091:Qumështi dhe kremi me përmbajtje të yndyrës të peshës prej > 3%	Po (10%)	7,447	7,661	7,782	7,711	8,155
6	16010099:Sallam dhe produkte të ngjashme të mishit	Jo	6,316	6,506	6,175	6,974	7,242
7	09012100:Kafeja e pjekur (përv. asaj të dekafenizuar)	Po (10%, Plani 7 Vjeçar i Reduktimit)	4,491	4,702	5,739	6,116	6,953
8	21041000:Supat dhe lëngjet e mishit dhe përgatitjet prej tyre	Jo	4,354	4,106	3,630	3,876	3,810
9	04069023:Edam (përveç djathit të grirë apo të pudëruar dhe për përpunim)	Jo	2,321	2,215	3,465	4,716	5,277
10	18063100:Çokollatat dhe përgatitje të tjera ushqimore që përmbajnë kakao	Jo	2,691	3,155	3,532	3,916	4,184
11	04039059:Dhallë, qumësht dhe krem i prerë	Po (10%, Plani 7 Vjeçar i Reduktimit)	2,549	2,235	3,494	3,815	4,118
12	18063210:Çokollatat dhe përgatitje të tjera ushqimore që përmbajnë kakao	Jo	2,870	3,174	2,946	3,480	3,246
13	19021910:Pasta të pagatuara, jo të mbushura apo të gatuara ndryshe	Jo	2,677	2,878	3,060	3,472	3,426
14	02071460:Këmbët e ngrira dhe prerjet prej tyre të shpendëve të llojit Gallus domesticus	Po (10%, Plani 7 Vjeçar i Reduktimit)	1,091	1,769	2,497	5,523	4,312
15	02012030:Cerekë të ndarë apo të pandarë të gjedhëve	Po (10%, Plani 5 Vjeçar i Reduktimit)	2,468	3,099	3,795	3,018	2,519

Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës; MSA.

3.6. Produktet e Reja Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Tregtuara pas MSA-s

Pas hyrjes në fuqi të MSA-s, 104 produkte të reja bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) janë eksportuar në BE, që tregon se kjo marrëveshje ka kontribuar në shumëllojshmërinë e portofolit të eksportit; 51 ishin nga Kreu IV: artikujt ushqimor, pijet dhe alkoolët; 50 nga Kreu II: produktet vegjetale; dhe vetëm 3 nga Kreu III: dhjamrat dhe vajrat shtazore dhe vegjetale. Në aspektin monetar, produktet e reja nga Kreu II kanë arritur në EUR 4.4 milion (54 për qind); ato nga Kreu IV ishin EUR 3.8 milion (shih Tabelën 9). Shuma

e përgjithshme e eksporteve të produkteve të reja ishte EUR 8.2 milion – që është 40 për qind e të gjitha eksporteve të produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) në vitin 2018.

Tabela 9: Produktet e Reja të Eksportuara në BE pas MSA-s

Krerët	N.	Vlera (në 000 EUR)	%
Kreu I: KAFSHËT E GJALLA DHE PRODUKTET SHTAZORE	-	0,000	0%
Kreu II: PRODUKTET VEGJETALE	50	4,460	54%
Kreu III: DHJAMRAT DHE VAJRAT SHTAZORE APO VEGJETALE	3	0,013	0%
Kreu IV: ARTIKUJT USHQIMOR, PIJET DHE ALKOOLET	51	3,818	46%
Totali i Eksporteve të Reja	104	8,291	100%

Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës.

Nga ana tjetër, rreth tri herë më shumë produkte të reja janë importuar nga BE-ja se sa janë eksportuar – në total 366. Më konkretisht, 144 produkte të reja janë importuar nga Kreu IV: artikujt ushqimor, pijet dhe alkoolet; 104 nga Kreu I: kafshët e gjalla dhe produktet shtazore; 95 nga Kreu II: produktet vegjetale; dhe 23 nga Kreu III: dhjamrat dhe vajrat shtazore dhe vegjetale. Sa i përket vlerës së tyre monetare, produktet e reja nga Kreu IV arrijnë në EUR 13.9 milion (54 për qind); ato nga Kreu II ishin EUR 9.0 milion (35 për qind). Dy krerët e tjerë kanë shuma më të vogla: Kreu I, 1.8 EUR milion (7 për qind); dhe Kreu III, EUR 0.9 milion (4 për qind). Shuma e përgjithshme e eksporteve të produkteve të reja ishte EUR 25.7 milion (shih Tabelën 10).

Tabela 10: Produktet e Reja të Importuara nga BE-ja pas MSA-s

Krerët	N.	Vlera (në 000 EUR)	%
Kreu I: KAFSHËT E GJALLA DHE PRODUKTET SHTAZORE	104	1,815	7%
Kreu II: PRODUKTET VEGJETALE	95	9,028	35%
Kreu III: DHJAMRAT DHE VAJRAT SHTAZORE APO VEGJETALE	23	0,996	4%
Kreu IV: ARTIKUJT USHQIMOR, PIJET DHE ALKOOLET	144	13,921	54%
Totali i Importeve të Reja	366	25,760	100%

Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës.

4. Koncesionet dhe Tarifat Ekzistuese

Me MSA-n, si BE-ja, ashtu edhe Kosova kanë bërë zotime për liberalizim të tregtisë së produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit). Në fakt, BE-ja ka avancuar të ashtuquajturat Masat Autonome Tregtare (MAT), të cilat i ofruan shumicës qasjen pa doganë (rreth 90 për qind) të produkteve në BE. Edhe Kosova ka pasur rreth 164 produkte, që janë përjashtuar nga taksat doganore me *Ligjin për Përjashtim të Mallrave nga Taksa Doganore dhe Mallrave me Normë Zero të Taksës Doganore*,⁷ i cili u miratua para hyrjes në fuqi të MSA-s.

Përkundër zotimeve të të dyja palëve për të çrrënjësuar tarifën dhe detyrimet doganore që kanë efekt të njëjtë në tregtinë e krerëve të produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit), ka akoma produkte që mbrohen nga tarifa të importit. BE-ja ende vendos forma të ndryshme të tarifave të importit në Kosovë për disa produkte të kafshëve të gjalla/mishit, përfshirë mishin e viçit; sheqerërat; dhe vera. Përveç kësaj, Kapitulli 7 dhe Kapitulli 8 i NK-s, që përbëhen nga frutat dhe produktet vegjetale, do të lirohen vetëm nga *tarifa ad valorem*. BE-ja do të vazhdojë të zbatojë tarifa të veçanta për disa produkte nga këta dy kapituj dhe rezervon të drejtën për të vepruar kështu me të tjerët në të ardhmen – duke ndikuar kështu në parashikueshmërinë e eksportuesve dhe si të tilla në prirjen e tyre për eksport. Një analizë ndër-vendore tregon se BE-ja ka mbrojtur në marrëveshjet me vendet tjera fqinje kategorinë e njëjtë të produkteve. Lista e detajuar e tarifave të BE-s të vendosura për Kosovën është dhënë në *Shtojca Ia* dhe *Shtojca Ib*.

Nga njëra anë, Kosova kryesisht vendos tarifa të cilat do të ulen gradualisht në afat kohor prej pesë deri në dhjetë vjet. Produktet, siç janë: kafeja dhe produktet e kafesë; lëngjet e frutave; reçelët dhe marmelada; mielli; mishi dhe mishi i shpezëve; dhe djathi, janë subjekt i këtyre tarifave kalimtare. Baza kundër së cilës reduktohet tarifa është 10 për qind. Kjo është taksë bujqësore e zbatuar në Kosovë me 31 dhjetor, 2013. Ndryshe nga kjo, 14 produkte të tjera bujqësore siç janë: qumështi, jogurti, patatet e papërpunuara, molla dhe vera dhe të tjerët, do të jenë gjithmonë subjekt i taksës bazë prej 10 për qind, përveç nëse ato negociohen sërish. Për më shumë informata të hollësishme mbi tarifën e Kosovës për BE-n, shih *Shtojca IIIa, IIIb, IIIc, IIId, Shtojca V, dhe Protokollin II* të dokumentit të MSA-s.

Një analizë e koncesioneve dhe tarifave ekzistuese të vendosura nga BE-ja në importet e produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) me origjinë nga Kosova tregojnë se EUR 19.1 milion apo 92 për qind të eksporteve të Kosovës në BE në vitin 2018 ishin pa tarifa. Kjo pritej, duke pasur parasysh se me MSA-n shumica dërrmuese e produkteve janë të liruara nga taksat doganore. Përveç verës (në veçanti, vera tjetër) e cila ka shënuar eksport të lartë në vitin 2018, dhe tri produkte vegjetale që shënuan eksporte shumë të ulëta, të tjerët (më shumë se 100 produkte bujqësore dhe të peshkut (peshkimit në nivel tetë-shifror), që janë subjekt i tarifave të BE-s, nuk kanë shënuar eksporte në BE. Megjithatë duket se tarifën nuk paraqesin shumë problem, sepse nuk ka pasur eksporte të produkteve të tilla (apo sasi shumë të vogla) as me pjesën tjetër të botës. Për më shumë informata, shih Tabelën 11.

⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8987>

Tabela 11: Eksportet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës në BE, sipas Tarifave (në 000 EUR)


Eksportet, sipas Tarifave	2018 (në 000 EUR)
Tarifat e kushtëzuara me Çmimin e Produktit	0,099
0702:DOMATE, TË FRESKËTA APO TË FTOHURA	0,049
0808: Mollë, dardhë dhe ftonj, të freskët	0,050
Tarifat e veçanta	0,082
0712: Perime të thara	0,082
Kuota	1,363
	1,363
2204:Vera pre rrushit të Freskët	(2.3 mil. litra)
Tarifa Zero	19,161
Grand Total	20,705

Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës; MSA.

Katrori 1: Eksporti i Verës

Eksportet e verës të klasifikuar si verë tjetër (CN:220421 dhe 220429), të cilat i nënshtrohen një kuote të përgjithshme prej 4 milion litrash (40 mijë hl), përbënte 2.3 milion litra (2.3 mijë hl) në vitin 2018, që do të thotë se është shfrytëzuar vetëm 55 për qind e kuotës. Nga ana tjetër, eksportet e verës të klasifikuara si verë e gazuar (CN:220410), e cila i nënshtrohet kuotës prej 1 milion litra (10 mijë hl), ishin të parëndësishme kundrejt verërave tjera, që arrinin vetëm 4.2 mijë litra, një normë shfrytëzimi prej 0.4 për qind. Duke e ditur avantazhin krahasues të sektorit të verës, është organizuar një takim me përfaqësuesit e bizneseve. Ata zakonisht pohojnë se plani i tyre është të investojnë në zgjerimin e eksporteve të verës të klasifikuar si verëra tjera (CN:220421 dhe 220429) dhe për këtë arsye do të nevojitej një kuotë më e lartë, prej 6-8 milion litrash. Të dhënat tregtare, nga ana tjetër, tregojnë se eksportet e verërave të tilla kanë pësuar rënie krahasuar me vitin 2015 (shih Grafikën 11), duke vënë në pikëpyetje kapacitetin e prodhuesve vendor për të shfrytëzuar kuotën. Megjithatë, me kusht që të mos kërkohen shumë mundësi për koncesione të tjera, ngritja e kuotës për këtë kategori të verës është një nga koncesionet që do të mund të merren parasysh, nëse Qeveria e Kosovës vendos të aktivizojë Nenin 33.

Grafika 11: Eksportet e verës të klasifikuar si verë tjetër (in 000,000 Litra)



Përveç kësaj, Tabela 12 paraqet listën e produkteve shumë të eksportuara në pjesën tjetër të botës, por në sasi shumë të vogla në BE. Por asnjë nga to nuk i nënshtrohet tarifave të vendosura nga BE-ja. Ka produkte të tilla si patatet, të freskëta apo të ftohëta (CN: 07019090), të cilat janë eksportuar 153,349 herë më shumë në pjesën tjetër të botës se sa në BE. Ky aktivitet i ulët i eksportit ka të ngjarë t'i atribuohet masave jo-tarifore, siç janë: infrastruktura e dobët e cilësisë (mungesa e standardeve sanitare dhe fito-sanitare); mungesa e testimit dhe certifikimit të përshtatshëm; objektet e dobëta të përpunimit; toka e pakonsoliduar; dhe kufizimet e përgjithshme në mjedisin afarist dhe pengesa të tjera të ngjashme.

Tabela 12: Ndryshimi ndërmjet Eksporteve të Kosovës në Pjesën Tjetër të Botës dhe në BE (në 000 EUR dhe and Ratios)

Malli (8 Shifror)	Tarifat	BE (2014-2018)	Pjesa Tjetër e Botës (2014-2018)	Pjesa Tjetër e Botës /BE
22021000:Ujërat, përf. ujërat minerale dhe të gazuara, me sheqer shtesë	Jo	5,751	26,787	5
22030001:Birrë e bërë nga malti, në shishe që mbajnë <= 10 l	Jo	0,354	23,377	66
11010011:Mielli nga gruri durum	Jo	0,031	12,747	409
09012100:Kafeja e pjekur (përv. e dekafeinizuar)	Jo	2,119	10,256	5
18063100:Çokollata dhe përgatitjet tjera që përmbajnë kakao	Jo	1,173	9,570	8
11010015:Mielli prej grurit të zakonshëm dhe grurit spelta	Jo	0,007	8,636	1,326
07019090:Patatet, e freskëta dhe të ftohura	Jo	0,000	8,281	153,349
22029010:Pijet jo-alkoolike, që nuk përmbajnë qumësht	Jo	1,837	5,677	3

Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës; MSA.

Tabela 13 analizon importet e produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) të Kosovës nga BE-ja, si të atyre të cilave u është dhënë qasje pa tarifa dhe atyre që i nënshtrohen tarifave. Importet me normë tarifore zero arritën në EUR 224.4 milion në vitin 2018, duke përbërë 76 për qind të të gjitha importeve. Produktet që janë subjekt i tarifave të tipit I dhe II arrijnë në EUR 27.0 milion, përkatësisht EUR 30.0 milion, e që të dyja përbëjnë 19 për qind të të gjitha eksporteve; pjesa tjetër, EUR 14.5 milion (5 për qind) përbëhet nga produktet që janë subjekt i tarifave të tipit III dhe IV. Duket se ulja e taifave ka pasur ndikim në importe. Tipi I dhe II, me kohën më të shkurtër të reduktimit, u pasuan nga rritjet e konsiderueshme të importeve, 58 për qind, përkatësisht 32 për qind.

Tabela 13: Importet e Produkteve Bujqësore dhe të Peshkut (Peshkimit) të Kosovës, sipas tarifave (në 000 EUR and %)

Importet, sipas Tarifave	2015	2018	Ndryshimi (%)
Norma Tarifore Zero	195,834	224,465	15%
Tipi I: Reduktimi Gradual i Tarifave, 5 vjet	17,106	27,080	58%
Tipi II: Reduktimi Gradual i Tarifave, 7 vjet	22,768	30,022	32%
Tipi III: Reduktimi Gradual i Tarifave, 8 vjet	3,247	3,418	5%
Tipi IV: Taksa bazë 10%	10,054	11,175	11%
Totali i Përgjithshëm	249,010	296,161	19%

Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës; MSA.

Tabela 14 paraqet listën e produkteve të importuara në sai relativisht të mëdha nga vendet që nuk janë në BE. Vini re se janë përzgjedhur vetëm ato që kanë tarifa të importit. Mund të merret parasysh përsheptimi i periudhës së tranzicionit të tarifave me kusht që importet e produkteve të tilla të mos pengojnë zhvillimin e prodhuesve vendor – natyrisht nëse Qeveria vendos të aktivizoj Nenin 33. Kjo do të

ndihmonte në shumëllojshmëri të importeve, që nga ana tjetër do të zvogëlonte varësinë nga vendet me ofertë shumë të kufizuar, nxiste konkurrencën dhe si rrjedhojë do të ulëshin çmimet.

Tabela 14: Ndryshimi ndërmjet Importeve të Kosovës nga Pjesa Tjetër e Botës dhe në BE (në 000 EUR dhe Përpjestimet)

Malli (8-Shifror)	Tarifat	BE (2014-2018)	Pjesa Tjetër e Botës (2014- 2018)	Pjesa Tjetër e Botës/BE
09011100:Kafeja	<i>Reduktim gradual i tarifave, 7 vjet</i>	0,020	55,756	2,726
02071450:Gjokse të ngrirja dhe prerje prej tyre	<i>Reduktim gradual i tarifave, 7 vjet</i>	0,849	36,877	43
07020000:Domatet, të freskëta dhe të ftohura	<i>Reduktim gradual i tarifave, 10 vjet</i>	0,404	27,195	67
16023230 Mishi i përgatitur apo i ruajtur	<i>Reduktim gradual i tarifave, 7 vjet</i>	3,045	20,778	7
16023929:Mishi i gatuar, përgatitur apo i ruajtur apo prej të brendshmëve të patës	<i>Reduktim gradual i tarifave, 7 vjet</i>	0,181	14,327	79
08071100:Shalqinj të freskët	<i>Reduktim gradual i tarifave, 10 vjet</i>	1,791	12,547	7
07070005:Kastravecat, e freskët apo të fthohur	<i>Reduktim gradual i tarifave, 10 vjet</i>	1,033	7,679	7
04012019:Qumështi dhe kremi prej përmbajtjes së yndyrës të peshës prej <= 3%	<i>Reduktim gradual i tarifave, 7 vjet</i>	0,009	4,885	543
07049010:Lakër e bardhë dhe e kuqe, e freskët dhe e fthohur	<i>Reduktim gradual i tarifave, 10 vjet</i>	0,246	3,524	14

Burimi: Llogaritjet e autorit bazohen në të dhënat nga Dogana e Kosovës; MSA.

5. Vërejtjet Përfundimtare

Shqyrtimi i të dhënave të tregtisë bilaterale tregon se MSA-ja ndërmjet Kosovës dhe BE-s duket se ka pasur ndikim pozitiv në tregtinë e produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) (Kapitujt 1-24). Dy vjet pas hyrjes në fuqi të MSA-s, eksportet e produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) u dyfishuan, ndërsa importet u rritën për një të pestën. Megjithatë, në vlerën monetare, rritja e importeve ishte katër herë më e lartë se rritja e eksporteve, që tregon se ka disbalans të madh tregtar për Kosovën.

Përveç kësaj, MSA-ja duket se ka dhënë kontribut të madh në shumëllojshmërinë e tregtisë. Pas hyrjes së saj në fuqi, janë tregtuar 470 produkte të reja bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) midis Kosovës dhe BE-s.

Në vijim janë disa vërejtje tjera që lidhen me mundësinë e aktivizimit të Nenit 33 të MSA-s që do të shërbejë si mjet për Qeverinë e Kosovës për të menduar. Mirëpo, është Qeveria e Kosovës ajo që duhet ta bëjë vet vlerësimin nëse është e mundshme që ky proces të shtyhet përpara. Por, duhet theksuar se asnjëri nga vendet fqinje nuk e ka aktivizuar këtë nen, i cili ishte gjithashtu pjesë e MSA-ve të tyre. Kjo ndodh kryesisht për shkak të kompleksitetit që e ka ky proces.

Shqyrtimi i hollësishëm i të dhënave dhe koncesioneve tregtare të parashikuara nga MSA-ja tregon se aktivizimi i Nenit 33 nuk mund të sjellë përmirësime të rëndësishme për Kosovën. Me përjashtim të verës, produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit), që shënuan eksporte të vazhdueshme në BE dhe ato që mund të eksportohen potencialisht në BE, nuk i nënshtrohen tarifave të vendosura nga BE-ja si pjesë e MSA-s. Megjithëse, kjo gjendje nuk garantohet për produktet nga Kapitulli 7 (zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës) dhe nga Kapitulli 8 (frutat dhe arrat e ngrënshme), pasi BE-ja rezervon të drejtën të vendosë tarifa të veçanta për to në të ardhmen. Kjo në parim, ndikon në parashikueshmërinë e eksportuesve dhe si rrjedhojë prirjen e tyre për eksport. Sidoqoftë, kufizimet e ofertës siç janë: infrastruktura e dobët e cilësisë (mungesa e standardeve sanitare dhe fito-sanitare); mungesa e testimit dhe certifikimit; objektet e dobëta të përpunimit; toka e pakonsoliduar; dhe kufizimet e përgjithshme në mjedisin afarist, duket të jenë pengesat kryesore për eksportet e produkteve bujqësore dhe të peshkut (peshkimit) të Kosovës.

Vera e klasifikuar si verë tjetër (CN:220421 and 220429) është kategoria më e shquar eksportuese e Kosovës kur bëhet fjalë për produktet bujqësore dhe të peshkut (peshkimit), e cila mbrohet nga BE-ja. Kuota vjetore për këtë kategori është 4 milion litra (40 mijë hl). Kjo kuotë ishte afër shfrytëzimit në vitin 2016 (92.5 për qind norma e shfrytëzimit), por në dy vitet e ardhshme (2017 dhe 2018) ka pasur rënie në eksporte, duke shfrytëzuar vetëm 50 për qind, respektivisht 55 për qind të kuotës. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e sektorit të verës besojnë se perspektiva e këtij sektori është mjaft premtuese, që nënkupton se kuota mund të arrihet shumë lehtë. Do të thotë se mund të konsiderohet rritja e kuotës prej 4 milion litrash (40 mijë litra) në 6 milion (60 mijë litra), nëse Qeveria e Kosovës aktivizon Nenin 33.

Një çështje që meriton vëmendje është *Direktiva Nr 206/2010* e BE-s, e cila ndalon produktet e Kosovës me origjinë shtazore të hyjnë në BE. Si rezultat i kësaj pengese, asnjë produkt me origjinë shtazore nuk është eksportuar në BE. Prandaj, para spikatjes së çështjes së tarifave ekzistuese për disa produkte me origjinë shtazore, kjo është Direktiva e cila duhet të merret me të. Për ta sqaruar këtë, Kosova ka eksportuar një sasi të konsiderueshme të produkteve me origjinë shtazore në pjesën tjetër të botës – përsëri për shkak të kufizimeve të ofertës.

Nga ana tjetër, ka mundësi për të përshpejtuar periudhën e tranzicionit të tarifave për disa produkte bujqësore dhe të peshkut (peshkimit), të cilat importohen shumë nga BE-ja (gjegj. kafeja e pjekur, dhalla; shih Tabelën 8), dhe për disa të tjera që importohen shumë nga pjesa tjetër e botës, por jo nga BE-ja apo në sasi shumë të vogla (gjegj. kafeja e padekafenizuar, domatet, shalqinj të freskët; shih Tabelën 14). Kjo mund të ketë ndikim në shumëllojshmërinë e importeve, gjë që do të zvogëlonte varësinë nga shumë pak vende furnizimi dhe ndoshta do të kontribuonte në më shumë konkurrencë, që në parim do të çonte në çmime më të ulëta. Rishikimi i të dhënave tregtare tregon se këto produkte që kanë qenë subjekt i reduktimeve më të shpejta tarifore ka shënuar rritje më të lartë në importe kundrejt të tjerëve që janë subjekt i periudhave më të gjata të reduktimit të tarifave.

Shtojcat

Shtojca Ia

Produkti	Kodet e NK	Kuotat
Produktet e mishit të viçit	0102 29 51 10 0102 29 59 11 0102 29 59 21 0102 29 59 31 0102 29 59 91 0102 29 91 10 0102 29 99 21 0102 29 99 91 0201 10 00 91 0201 20 20 91 0201 20 30 91 50 91 20 30 91 0201 20 50 91	475 ton
Troftë (<i>Salmo trutta</i> , <i>Oncorhynchus mykiss</i> , <i>Oncorhynchus clarki</i> , <i>Oncorhynchus aguabonita</i> , <i>Oncorhynchus gilae</i> , <i>Oncorhynchus apache</i> dhe <i>Oncorhynchus chrysogaster</i>): e gjallë; e freskët apo e ftohur; e ngrirë; e tharë, e kriposur apo në kripë, e tymosur; file dhe mish i peshqve të tjerë; miellrat, kokrrizat dhe sferat, të përshtatshëm për konsum njerëzor	0301 91 00 0302 11 00 0303 14 00 0304 42 00 ex 0304 52 00 0304 82 00 ex 0304 99 21 ex 0305 10 00 ex 0305 39 90 0305 43 00 ex 0305 59 80 ex 0305 69 80	15 ton
Krapi (<i>Cyprinus</i> spp., <i>Carassius</i> spp., <i>Ctenopharyngodon idellus</i> , <i>Hypophthalmichthys</i> spp., <i>Cirrhinus</i> spp., <i>Mylopharyngodon piceus</i> , <i>Catla catla</i> , <i>Labeo</i> spp., <i>Osteochilus hasselti</i> , <i>Leptobarbus hoeveni</i> , <i>Megalobrama</i> spp.): i gjallë; i freskët apo i ftohur; e ngrirë; i tharë, i kriposur apo në kripë, i tymosur; file dhe mish i peshqve të tjerë; miellrat, kokrrizat dhe sferat, të përshtatshëm për konsum njerëzor	0301 93 00 0302 73 00 0303 25 00 ex 0304 39 00 ex 0304 51 00 ex 0304 69 00 ex 0304 93 90 ex 0305 10 00 ex 0305 31 00 ex 0305 44 90 ex 0305 59 80 ex 0305 64 00	20
Verë prej rrushit të freskët	ex 2204 21 ex 2204 29	40,000 (hl)
Verërat spumante cilësore; verë prej rrushit të freskët, në kontejnerë që mbajnë 2 litra apo më pak	ex 2204 10 ex 2204 21	10,000 (hl)

Vera prej rrushit të freskët, me fortësi alkoolike faktike ndaj masës jo më tepër se 15 % vëll., përveç verës spumante	ex 2204 21 93 ex 2204 21 94 ex 2204 21 95 ex 2204 21 96 ex 2204 21 97 ex 2204 21 98 ex 2204 22 93 ex 2204 22 94 ex 2204 22 95 ex 2204 22 96 ex 2204 22 97 ex 2204 22 98 ex 2204 29 93 ex 2204 29 94 ex 2204 29 95 ex 2204 29 96 ex 2204 29 97 ex 2204 29 98	30,000 (hl)
Mishi i vëçit	ex0102 90 51, ex0102 90 59, ex0102 90 71, ex0102 90 79, ex0201 10 00, ex0201 20 20, ex0201 20 30, ex0201 20 50,	475
Kallam sheqeri apo panxhar sheqeri dhe sukroza kimikisht e pastër, në gjendje të ngurtë Sheqer tjetër, përfshirë laktozën, maltozën, glukozën dhe fruktozën kimikisht të pastër, në gjendje të ngurtë; shurupet e sheqerit të nuk përmbajnë lëndë aromatizuese dhe ngjyruese shtesë, mjalti artificial, nëse është apo jo i përzier me mjaltë natyral; karamel	1701 1702	180,000

Shtojca Ib

Kapitulli	Kodi i NK	Duty
01:Kafshët e Gjalla	0102295110	2.000 % + 18.600 EUR DTN
01:Kafshët e Gjalla	102295911	2.000 % + 18.600 EUR DTN
01:Kafshët e Gjalla	0102295921	2.000 % + 18.600 EUR DTN
01:Kafshët e Gjalla	0102295931	2.000 % + 18.600 EUR DTN
01:Kafshët e Gjalla	0102295991	2.000 % + 18.600 EUR DTN
01:Kafshët e Gjalla	0102299110	2.000 % + 18.600 EUR DTN
01:Kafshët e Gjalla	0102299991	2.000 % + 18.600 EUR DTN
02:Mishi dhe të ngrënshmet e brëndshme të mishit	201100094	2.500 % + 35.300 EUR DTN
02:Mishi dhe të ngrënshmet e brëndshme të mishit	0201202092	2.500 % + 35.300 EUR DTN
02:Mishi dhe të ngrënshmet e brëndshme të mishit	0201203092	2.500 % + 28.200 EUR DTN
02:Mishi dhe të ngrënshmet e brëndshme të mishit	0201203094	2.500 % + 28.200 EUR DTN

02:Mishi dhe të ngrënshmet e brëndshme të mishit	0201205092	2.500 % + 42.400 EUR DTN
02:Mishi dhe të ngrënshmet e brëndshme të mishit	0201205094	2.500 % + 42.400 EUR DTN
07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	702000000	Cond: B cert: Y-090 (27);; B (07);; V 84.600 EUR/DTN(01):0.000 % ; V 82.900 EUR/DTN(01):0.000 % + 1.700 EUR DTN ; V 81.200 EUR/DTN(01):0.000 % + 3.400 EUR DTN ; V 79.500 EUR/DTN(01):0.000 % + 5.100 EUR DTN ; V 77.800 EUR/DTN(01):0.000 % + 6.800 EUR DTN ; V 0.000 EUR/DTN(01):0.000 % + 29.800 EUR DTN
07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	0703200000	0.000 % + 120.000 EUR DTN
07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	707000500	Cond: B cert: Y-090 (27);; B (07);; V 110.500 EUR/DTN(01):0.000 % ; V 108.300 EUR/DTN(01):0.000 % + 2.200 EUR DTN ; V 106.100 EUR/DTN(01):0.000 % + 4.400 EUR DTN ; V 103.900 EUR/DTN(01):0.000 % + 6.600 EUR DTN ; V 101.700 EUR/DTN(01):0.000 % + 8.800 EUR DTN ; V 0.000 EUR/DTN(01):0.000 % + 37.800 EUR DTN
07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	0709910000	Cond: B cert: Y-090 (27);; B (07);; V 82.600 EUR/DTN(01):0.000 % ; V 80.900 EUR/DTN(01):0.000 % + 1.700 EUR DTN ; V 79.300 EUR/DTN(01):0.000 % + 3.300 EUR DTN ; V 77.600 EUR/DTN(01):0.000 % + 5.000 EUR DTN ; V 76.000 EUR/DTN(01):0.000 % + 6.600 EUR DTN ; V 0.000 EUR/DTN(01):0.000 % + 22.900 EUR DTN
07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	0709929000	13.100 EUR DTN
07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	0709931000	Cond: B cert: Y-090 (27);; B (07);; V 41.300 EUR/DTN(01):0.000 % ; V 40.500 EUR/DTN(01):0.000 % + 0.800 EUR DTN ; V 39.600 EUR/DTN(01):0.000 % + 1.700 EUR DTN ; V 38.800 EUR/DTN(01):0.000 % + 2.500 EUR DTN ; V 38.000 EUR/DTN(01):0.000 % + 3.300 EUR DTN ; V 0.000 EUR/DTN(01):0.000 % + 15.200 EUR DTN
07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	0709996000	9.400 EUR DTN
07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	0711209000	13.100 EUR DTN
07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	0711510000	0.000 % + 191.000 EUR DTN E
07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	0712901900	9.400 EUR DTN
07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	0714209000	6.400 EUR DTN

07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	0714300000	9.500 EUR DTN
07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	0714400000	9.500 EUR DTN
07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	0714500000	9.500 EUR DTN
07: Zarzavatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës	0714902000	9.500 EUR DTN
08: Frutat dhe arrat e ngrënshme	0803901000	114.000 EUR TNE
08: Frutat dhe arrat e ngrënshme	0805501000	Cond: B cert: Y-090 (27); B (07); V 46.200 EUR/DTN(01):0.000 % ; V 45.300 EUR/DTN(01):0.000 % + 0.900 EUR DTN ; V 44.400 EUR/DTN(01):0.000 % + 1.800 EUR DTN ; V 43.400 EUR/DTN(01):0.000 % + 2.800 EUR DTN ; V 42.500 EUR/DTN(01):0.000 % + 3.700 EUR DTN ; V 0.000 EUR/DTN(01):0.000 % + 25.600 EUR DTN
08: Frutat dhe arrat e ngrënshme	0808108000	Cond: B cert: Y-090 (27); B (07); V 56.800 EUR/DTN(01):0.000 % ; V 55.700 EUR/DTN(01):0.000 % + 1.100 EUR DTN ; V 54.500 EUR/DTN(01):0.000 % + 2.300 EUR DTN ; V 53.400 EUR/DTN(01):0.000 % + 3.400 EUR DTN ; V 52.300 EUR/DTN(01):0.000 % + 4.500 EUR DTN ; V 51.100 EUR/DTN(01):0.000 % + 5.700 EUR DTN ; V 50.000 EUR/DTN(01):0.000 % + 6.800 EUR DTN ; V 0.000 EUR/DTN(01):0.000 % + 23.800 EUR DTN
08: Frutat dhe arrat e ngrënshme	0808309000	Cond: B cert: Y-090 (27); B (07); V 51.000 EUR/DTN(01):0.000 % ; V 50.000 EUR/DTN(01):0.000 % + 1.000 EUR DTN ; V 49.000 EUR/DTN(01):0.000 % + 2.000 EUR DTN ; V 47.900 EUR/DTN(01):0.000 % + 3.100 EUR DTN ; V 46.900 EUR/DTN(01):0.000 % + 4.100 EUR DTN ; V 0.000 EUR/DTN(01):0.000 % + 23.800 EUR DTN
08: Frutat dhe arrat e ngrënshme	0811101100	0.000 % + 8.400 EUR DTN
08: Frutat dhe arrat e ngrënshme	0811201100	0.000 % + 8.400 EUR DTN
08: Frutat dhe arrat e ngrënshme	0811901100	0.000 % + 5.300 EUR DTN
08: Frutat dhe arrat e ngrënshme	0811901900	0.000 % + 8.400 EUR DTN